**REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE**
**PRILL- MAJ-QERSHOR**
**2023**

| **Nr. Rendor** | **Data e kërkesës** | **Objekti i kërkesës** | **Data e përgjigjes** | **Përgjigje** | **Mënyra e përfundimit të kërkesës** | **Tarifa** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **1** | 05.04.2023 | Kërkesë për Informacion | 26.04.2023 | Në përgjigje të kërkesës tuaj nr. 2751/1 prot, dt. 04.04.2023 "Kërkesë për Informacion", protokolluar me tonën me nr. 1333 prot, dt. 05.04.2023, mbështetur në Ligjin Nr.139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, dhe në zbatim të Ligjit Nr.119/2014, date 18.09.2014 "Për të drejtën e informimit", ju dërgojmë informacionin sipas pikave të kërkesës suaj:<br><br>**1.**Sa eshte numri i objekteve të shembura pas tërmetit të vitit 2019 në total?<br><br>Numri i objekteve te shembura pas termetit është 117.<br><br>**2.**Sa eshte numri i tyre i ndare sipas klasifikimit te shkalles se rrezikshmerise? | E plotë | Pa Pagesë |

**Të gjitha kërkesat për informacion që kanë si përgjigje mbishkrimin: "Kthyer përgjigje në bazë të Kërkesës" janë shënuar në mënyrë të tillë për të ruajtur anonimitetin e personit fizik ndaj të cilit mund të jetë kërkuar informacion nga institucionet gjyqesore (prokurori, gjykata, etj).**

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Numri i objekteve te shembura, i ndare sipas klasifikimit te shkalles se rrezikshmerise eshte 117.<br><br>**3.** Sa prej ketyre objekteve te shembura paten vjetersi mbi 50-vjecare?<br><br>Numri i objekteve të ndërtuara para viteve '50 (kryesisht me structure mbajtese mure guri ose tulle) është 96 objekte, dhe numri i objekteve të ndërtuara pas viteve '50 (kryesisht me konstruksion skelet betonarme) është 21 objekte.<br><br>Duke ju falenderuar për bashkëpunimin! | | |
| **2** | 07.04.2023 | Kërkesë për Informacion | 11.04.2023 | Përshëndetje<br>Referuar kërkesës suaj për informacion, ju informojmë se Sektori i Arkivave Shtetëror Vendore Shkodër, Lezhë, Dibër dhe Kukës ndodhet në territorin e Bashkisë Mirditë, por është në administrim të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave. Për cdo informacion që kërkoni, jeni të lutur ti drejtoheni Drejtorisë së Përgjithsshme të Arkivave.<br>Ju faleminderit për mirëkuptimin | E plotë | Pa Pagesë |
| **3** | 13.04.2023 | Kërkesë për Informacion | 18.04.2023 | Kthyer përgjigje në bazë të kërkesës. | E plotë | Pa Pagesë |

**Të gjitha kërkesat për informacion që kanë si përgjigje mbishkrimin: "Kthyer përgjigje në bazë të Kërkesës" janë shënuar në mënyrë të tillë për të ruajtur anonimitetin e personit fizik ndaj të cilit mund të jetë kërkuar informacion nga institucionet gjyqesore (prokurori, gjykata, etj).**

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **4** | 18.04.2023 | Kërkesë për Informacion | 25.04.2023 | Nga verifikimet e kryera në regjistrin e kadastrës pyjore dhe hartat kadastrale të digjitalizuara në sistemin ALFIS rezulton se pasuritë nr 1,4 dhe 6 të jenë pasuri e bashkisë Mirditë, fond pyjor /kullesor , EP. Luginat e Rubikut, n/ ngastra nr 70/a, ZK.nr2125, pasuria nr 424.<br>1. Pasuria nr 1, vol 3,faqe 55, me ZK 2125, fshati: Katund I Vjetër , Njësia Administrative Rubik.<br>2. Pasuria nr 4, vol 2, faqe 127, me ZK 2125, fshati: Katund I Vjetër , Njësia Administrative Rubik.<br>3. Pasuria nr 6, vol 2 faqe 126, me ZK 2125, fshati: Katund I Vjetër , Njësia Administrative Rubik.<br>Ndërkohë pasuritë nr.2, 3, 7 dhe 8 nuk janë përshirë në fondin pyjor/ kullesor, si pasuri të paluajtshme të bashkisë Miditë. | E plotë | Pa Pagesë |
| **5** | 19.04.2023 | Kërkesë për Informacion | 26.04.2023 | Në përgjigje të kërkesës tuaj e administruar në bashki me nr.1526 Prot, datë 19.04.2023, ju informojmë:<br>Bashkia Mirditë ka lidhur kontratë me shoqërinë ndërtuese "Sang 1" me datë 27.11.2018.<br>Nuk kemi dhënë autorizim referuar formularit A/6. | E plotë | Pa Pagesë |
| **6** | 02.05.2023 | Kërkesë për Informacion | 03.05.2023 | Në përgjigje të kërkesës suaj datë 28.04.2023, protokolluar pranë institucionit tone me nr.1692 prot datë 02.05.2023 ju informojmë se | E plotë | Pa Pagesë |

**Të gjitha kërkesat për informacion që kanë si përgjigje mbishkrimin: "Kthyer përgjigje në bazë të Kërkesës" janë shënuar në mënyrë të tillë për të ruajtur anonimitetin e personit fizik ndaj të cilit mund të jetë kërkuar informacion nga institucionet gjyqesore (prokurori, gjykata, etj).**

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | në strukturën organike të Bashkisë Mirditë, nuk ekziston pozicion pune si Koordinator Për Edukim Ligjor. Faleminderit për bashkëpunimin! | | |
| **7** | 05.05.2023 | Kërkesë për Informacion | 12.05.2023 | **Neni 7, pika 1/b, i Ligjit për Rininë, parashikon për NJVV-të krijimin e Këshillit Vendor të Rinisë. Aktualisht në cilën fazë është procesi i themelimit të këtij këshilli në bashkinë tuaj? (***Është ngritur, është në proces administrativ për tu ngritur, apo është në plan për tu ngritur***?)**<br><br>Këshilli Vendorë Rinorë Mirditë është ngritur gjat vitit 2022 dhe mbledhja e parë konstituese është mbajtur me datë 26 Korrik 2022.<br><br>**1. Nëse Këshilli Vendor Rinor (KVR) është ngritur, ju lutemi informoni mbi:**<br>- Përbërjen e tij:<br>*KVR Mirditë përbëhet nga Kryetari i Bashkisë (Kryetar i KVR), të rinj të njësis administrative si Adi Dodaj, Meli Prenga, Eliza Tuci, David Kabali si dhe Elisara Gjini nga të rinjt e Administartës.*<br>- Nëse janë realizuar mbledhje dhe sa të tilla që prej ngritjes së KVR-së:<br>*Nga mbledhja e pare konstituese eshte realizuar edhe nje mbledhje tjeter. Gjat 2023 nuk kemi organizuar mbledhje për të mos lënë të insinuaojmë që të rinjt e KVR të jenë të përfshirë në fushatën zgjedhore duke qene se aktivitetet publike kanë filluar të ndalohen me fillimin e periudhës zgjedhore 4 muaj para zgjedhjeve.* | E plotë | Pa Pagesë |

**Të gjitha kërkesat për informacion që kanë si përgjigje mbishkrimin: "Kthyer përgjigje në bazë të Kërkesës" janë shënuar në mënyrë të tillë për të ruajtur anonimitetin e personit fizik ndaj të cilit mund të jetë kërkuar informacion nga institucionet gjyqesore (prokurori, gjykata, etj).**

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | 2. **Neni 7, pika 1/c parashikon organizimin dhe koordinimin e veprimtarive që synojnë arritjen e objektivave vendorë në fushën e mbrojtjes dhe të fuqizimit të të rinjve. Në këtë kuadër:**<br><br>- Në bashkinë tuaj a ka dokument lokal strategjik për rininë:<br>*Jo nuk ka*.<br>- Nëse po, a është i publikuar në faqen e Bashkisë?<br>*Jo nuk ka*.<br>- Nëse jo, a ka një plan në bashki që parashikon përmbushjen e ligjit në lidhje me këtë pikë?<br>*Ende jo nuk ka një plan të tillë por po punojmë për draftimin e një plani për Vullnetarizmin dhe për Rininë, proces që do të marri kohë pasi kemi nevojë për mbështetje nga organizata dhe donatorë për e planeve të tilla*.<br><br>3. **Neni 7, pika 1/dh, parashikon financimin e krijimit dhe të zhvillimit të infrastrukturës rinore dhe të hapësirave rinore të sigurta**.<br><br>- Në PBA aktuale a ka zë/zëra të dedikuar për këtë çështje në bashkinë tuaj?<br>*Jo nuk ka një zë të dedikuar*.<br>- Nëse po ju lutem specifikoni programin buxhetor përkatës në PBA 2023-2025.<br>*Jo nuk ka një zë të dedikuar*<br><br>4. **Neni 7, pika 1/e, parashikon krijimin e strukturave administrative për çështjet e rinisë.** | | |

**Të gjitha kërkesat për informacion që kanë si përgjigje mbishkrimin: “Kthyer përgjigje në bazë të Kërkesës” janë shënuar në mënyrë të tillë për të ruajtur anonimitetin e personit fizik ndaj të cilit mund të jetë kërkuar informacion nga institucionet gjyqesore (prokurori, gjykata, etj).**

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | - A ka një strukturë administrative për çështjet e rinisë në organikën e aparatit të bashkisë suaj? *Jo nuk ka*.<br><br>5. **Neni 7, pika 1/ë, përmend parashikimin, në buxhetet e tyre, të fondeve për realizimin progresiv të të drejtave të të rinjve për zhvillimin e projekteve, programeve dhe veprimtarive rinore**.<br><br>- A ka parashikuar bashkia juaj zë të dedikuar në PBA 2023-2025 për këtë çështje? *Jo nuk kemi linje te dedikuar per rinine, por për projekte me donator të huaj po ekëtu mund të aplikojmë për projekte që stimulojnë realizimin progresiv të të drejtave të të rinjëve.*<br><br>6. **Neni 7, pika 1/f parashikon mbledhjen, analizimin dhe raportimin e të dhënave, në bashkëpunim me institucionet e tjera, për situatën e të drejtave të të rinjve në territorin e tyre.**<br>- A e realizon bashkia juaj këtë detyrim? *Mbajtjen e statistikave dhe raportimin e tyre kur kerkohen e bejme por nuk kemi bërë ndonjë analizim të thelluar të këtyre të dhënave apo të dedikuar për këto të dhëna. Hera e fundit kur kemi marrë në analizë këtë kategori shoqërore ka qënë gjat procesit të hartimit të Planit të Strehimit (2023-2028).* | | |

**Të gjitha kërkesat për informacion që kanë si përgjigje mbishkrimin: "Kthyer përgjigje në bazë të Kërkesës" janë shënuar në mënyrë të tillë për të ruajtur anonimitetin e personit fizik ndaj të cilit mund të jetë kërkuar informacion nga institucionet gjyqesore (prokurori, gjykata, etj).**

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | **7. A ka institucioni juaj një databazë të organizatave rinore/për të rinjtë që operojnë në bashkinë tuaj?**<br><br>*Kemi një databazë për të gjitha organziatat e shoqëris civile që kanë seli në Mirditë apo që operojnë në Mirditë. Organzata rinore apo për të rinjt nuk ka në Mirditë.*<br><br>**8. A bashkëpunoni me organizata të shoqërisë civile për çështjet rinore (si përshembull nxitjen e vullnetarizmit të të rinjve dhe edukimin joformal të tyre)?**<br><br>*Po, bashkëpunojmë rregullisht. Albanian Skills është shoqata e fundit me të cilën kemi zhvilluar për rreth 40 të rinjë një ditë aftësimi për karrierën, Mary Ward Loreto dhe Vizion Ojf janë dy shoqata të tjera të cilat shpesh përfshijnë të rinjt në trajnime të tilla.*<br><br>**9. Si do ta vlerësonit këtë bashkëpunim?**<br><br>*Bashkëpunimi ka qenë korrekt dhe i vazhdueshëm.*<br><br>**10. Neni 7.pika 4 parashikon se Njësitë e vetëqeverisjes vendore bashkëpunojnë me organizatat për të rinjtë e organizatat rinore shqiptare në diasporë, për të mbajtur komunikimin me të rinjtë shqiptarë që janë larguar nga vendi për arsye studimesh ose të tjera, me qëllim angazhimin në aktivitetet që zhvillohen në Republikën e Shqipërisë.**<br>- Keni raste bashkëpunimi të këtij kuadri?<br>*Jo nuk kemi.* | | |

**Të gjitha kërkesat për informacion që kanë si përgjigje mbishkrimin: "Kthyer përgjigje në bazë të Kërkesës" janë shënuar në mënyrë të tillë për të ruajtur anonimitetin e personit fizik ndaj të cilit mund të jetë kërkuar informacion nga institucionet gjyqesore (prokurori, gjykata, etj).**

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | **11. A jeni angazhuar në realizimin e masave të parashikuara në Strategjinë Kombëtare për Rininë 2022-2029 për Bashkitë? Nëse po, ju lutemi të paraqisni informacion në çfarë faze është ky proces.**<br><br>*Masat e parashikuara Startegjia Kombëtare e Rinisë 2022-2023 do të përpiqemi fillimisht në një plan lokal për Rininë dhe sigurisht do të zbatojmë së shpejti ato masa të cilat vlerësojmë të realizueshme nga ana jonë.* | | |
| **8** | 17.05.2023 | Kërkesë për Informacion | 26.05.2023 | Bazuar në kompetencat dhe detyrimet sipas Ligjit nr. 139/2015, për "Vetëqeverisjen vendore", të Ligjit Nr. 10.465, datë 29.09.2011, "PËR SHËRBIMIN VETERINAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË ", neni 54, gërma "c" dhe bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 230, datë 20.03.2013, "Për përcaktimin e funksioneve, detyrave specifike dhe standardeve të shërbimit veterinar të qeverisjes vendore", kapitulli VI, "MBIKËQYRJA DHE MBAJTJA NË KONTROLL E QENVE DHE MACEVE ENDACAKE PA PRONARË ", kërkoj nga ana juaj informacionet për:<br>**1.** Si është i organizuar shërbimi veterinar në bashkinë tuaj? - Shërbimi veterinar në bashkinë Mirditë është i organizuar si Sektori i Shërbimit Veterinar, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (SHVUMK) që funksionon pranë Agjencisë së Shërbimeve Bujqësore Veterinare dhe Pyjore (ASHBVP). | E plotë | Pa Pagesë |

**Të gjitha kërkesat për informacion që kanë si përgjigje mbishkrimin: "Kthyer përgjigje në bazë të Kërkesës" janë shënuar në mënyrë të tillë për të ruajtur anonimitetin e personit fizik ndaj të cilit mund të jetë kërkuar informacion nga institucionet gjyqesore (prokurori, gjykata, etj).**

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | **2.** Sa veteriner janë në strukturën e shërbimit veterinar? - Në strukturën e shërbimit veterinar janë 3(tre) veteriner.<br>**3.** Sa është fondi i përcaktuar në buxhet për shërbimin veterinar në 5 vitet e fundit (specifikojeni sipas secilit vit)? - Nuk kemi fonde .<br>**4.** A keni hartuar program pune të profilaksisë veterinare në lidhje me situatën epizootike të qenve dhe maceve të rrugës, si edhe programe për kontrollin dhe lëvizjen e tyre? - Jo nuk kemi.<br>**5**. A i keni identifikuar qentë dhe macet e rrugës në territorin që administroni? - Jo nuk janë identifikuar.<br>**6**. Si e organizoni sterilizimin e organeve të riprodhimit të qenve dhe të maceve të rrugës? - Nuk e kryejmë si shërbim.<br>**7**. Si i grumbulloni qentë dhe macet e rrugës? -Nuk e kryejmë si shërbim.<br>**8**. A keni vende të posaçme, të miratuara, në të cilat i dërgoni?<br>- Jo nuk kemi.<br>**9.** Në cilat raste realizoni eliminimin e qenve dhe të maceve të rrugës dhe si e realizoni procesin?<br>- Jo nuk kemi kryer.<br>1**0.** A keni konstatuar raste ku ka pasur braktisje të qenve dhe maceve nga pronarët përkatës dhe çfarë masash keni marrë?<br>- Jo nuk kemi patur raste të konstatuara.<br>**11.** Çfarë masash keni marrë që në ambientet publike, si: rrugë , parqe, kënde lojërash etj., kafshë te shoqërimit të mos paraqesin rrezik për njerëzit ose për kafshë te tjera?<br>- Janë vendosur njoftime dhe sinjalistika në çdo ambjent publik.<br>**12**. Çfarë masash keni marrë për të vendosur dhe për të zbatuar në territorin që administroni, detyrimin për pronaret që të vendosin | | |

**Të gjitha kërkesat për informacion që kanë si përgjigje mbishkrimin: “Kthyer përgjigje në bazë të Kërkesës” janë shënuar në mënyrë të tillë për të ruajtur anonimitetin e personit fizik ndaj të cilit mund të jetë kërkuar informacion nga institucionet gjyqesore (prokurori, gjykata, etj).**

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | maskën mbrojtëse në gojë për qentë e shoqërimit të racave agresive gjatë që ndrimit të tyre në ambientet publike?<br>- Janë vendosur njoftime dhe sinjalistika në çdo ambjent publik.<br>**12**. A keni konstatuar raste të helmimit të qenve dhe të maceve të rrugës?<br>- Jo nuk kemi konstatuar raste të tilla.<br>**13.** A keni referuar tek autoritetet ligjzbatuese raste të braktisjes, helmimit apo të vrasjes së qenve apo të maceve të rrugës?<br>- Jo nuk ka patur raste .<br>**14.** A keni informacion për sjelljen e maceve dhe kafshëve të rrugës nga territore të tjera të vendit në territorin e bashkisë suaj?<br>- Jo nuk kemi informacion.<br>**15**. A keni marrë ankesa për mënyrën se si e menaxhoni situatën e maceve dhe të qenve të rrugës?<br>- Jo nuk kemi.<br>**16.** A keni ngritur qendra vaksinimi, kastrimi dhe sterilizimi për macet dhe qentë e rrugës?<br>- Jo nuk ka asnjë qendër.<br>**17**. A keni qendra të ngritura për macet dhe qentë e rrugës?<br>- Jo.<br>**18.** A keni strehëza të përhershme të ngritura për macet dhe qentë e rrugës që janë në pritje të adoptimit?<br>- Jo nuk kemi.<br>**19.** Si funksionon adpotimi i qenve dhe i maceve të rrugës që ju i grumbulloni në territorin tuaj, nëse e ofroni këtë shërbim?<br>- Nuk e ofrojmë këtë shërbim. | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |

**Të gjitha kërkesat për informacion që kanë si përgjigje mbishkrimin: "Kthyer përgjigje në bazë të Kërkesës" janë shënuar në mënyrë të tillë për të ruajtur anonimitetin e personit fizik ndaj të cilit mund të jetë kërkuar informacion nga institucionet gjyqesore (prokurori, gjykata, etj).**

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |

**Të gjitha kërkesat për informacion që kanë si përgjigje mbishkrimin: "Kthyer përgjigje në bazë të Kërkesës" janë shënuar në mënyrë të tillë për të ruajtur anonimitetin e personit fizik ndaj të cilit mund të jetë kërkuar informacion nga institucionet gjyqesore (prokurori, gjykata, etj).**